



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 nënparagrafi d), nenit 40.2 nen c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.3/L-040, Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 40 nen piken 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të datës 07.03.2019, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të, të mbajtur më datën 29.03.2019, mori këtë:

V E N D I M

Për bartjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat e vitit 2018 në vitin 2019

I

Miratohet vendimi për bartjen dhe ridestinimin e mjeteve të mbetura nga të hyrat e vitit 2018 në vitin 2019 në shumën prej 298,998.53 €, €.

II

Kjo shumë si në pikën 1 të këtij vendimi shpërndahet në programe dhe nen-programe buxhetore dhe kategori ekonomike si në vijim:

- Paga dhe medetje në shumë prej 14,692.90 €
- Mallra dhe shërbime në shumë prej 29,106.46 €
- Shpenzime komunale në shumë prej 101.77 €;
- Subvencione dhe transfere në shumë prej 20,026.00 € dhe
- Shpenzime kapitale në shumë prej 235,071.40 €.

Në kategorinë ekonomike paga dhe medetje shuma prej 14,692.90 €, në programin:

Shëndetësi dhe mirëqenia sociale (730) nën-programi (74050), kodi funksional (0721) shuma prej 14,692.90 €.

Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej 29,106.46 € në programin:

Arsimi dhe Shkenca (920) nën-programi (92090), kodi funksional (0980) shuma prej 14,106.46 € dhe **Shëndetësi dhe mirëqenia sociale** (730) nën-programi (74050), kodi funksional (0721) shuma prej 15,000.00 €.

Në kategorinë ekonomike shpenzime komunale shuma prej 101.77 € në programin:

Buxhet e financa (175) nën-programi (17518) kodi funksional (0112) shuma prej 101.77 €.

Në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shuma prej 20,026.00 € në programin:

Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural (470) nën-programi (47018), kodi funksional (0421) shuma prej 20,026.00 €

Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale shuma prej 235,071.40 € në programet, nen-programet dhe projektet si vijon:

Në programin Shërbimet Publike Mbrojtja Civile (180) nën-programi (18018), kodi funksional (0451), shuma prej 1,707.36 €, në projektin :

“ Sinjalizimi i rrugëve “ , kodi (44870) shuma prej 1,707.36 €

Në programin Bujqësi , pylltari dhe zhvillim rural (470) nën-programi (47018), kodi funksional (0421) shuma prej 30,806.74 €, në projektet :

“ Kanali për ujitje në Kpuz “ , kodi (45512) shuma prej 20,806.74.00 € dhe

“ Kanali për ujitje në Rudicë “ , kodi (46903) shuma prej 10,000.00 €

Në Programin Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66395), kodi funksional (0620), shuma prej 168,428.63 €, në projektet :

“ Asfaltimi i rrugëve lokale në Gremnik “ , kodi (47171) shuma prej 15,337.88 €

“ Hartat zonale “ , kodi (44510) shuma prej 20,000.00 €

“ Asfaltimi i rrugës në Radulloc “ , kodi (47192) shuma prej 24,752.28 €

“ Meremetimi i vorrezave të deshmorve “ , kodi (47197) shuma prej 21,035.08 €

“ Asfaltimi i rrugëve lokale në Gllarevë, Rixhevë dhe Stapanicë “ , kodi (47294) shuma prej 51,578.64 €

“ Ndërtimi i urës në Shtaricë “ , kodi (47194) shuma prej 14,926.71 € dhe

“ Ndërtimi i urës në Ujmirë “ , kodi (47362) shuma prej 20,798.04 €

Në programin Arsimi dhe Shkenca (920) nën-programi (92090), kodi funksional (0980) shuma prej 30,153.02 €, në projektet :

“ Renovimi i objektit të gjimnazit Luigj Gurakuqi “ , kodi (44909) shuma prej 24,000.00 €

“ Ndërtimi i fushës së sportit në shf. Jashanicë “ , kodi (46882) shuma prej 1,161.02 € dhe

“ Rregullimi i dyshemesë në shf. Emin Duraku “ , kodi (46860) shuma prej 4,992.00 €

Në programin Shëndetësi dhe mirëqenia sociale (730) nën-programi (74050), kodi funksional (0721) shuma prej 3,975.65 €, në projektin :

“ Lyerja e objektit të QKMF-së “ , kodi (45007) shuma prej 3,975.65 €

Koment: Me këtë kërkesë të bartjes së të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019, kemi ndryshim të strukturës së shpenzimeve nga kategoria e shpenzimeve kapitale në kategorinë subvencione dhe transfere në shumë prej 20,000.00 € dhe nga kategoria e paga e meditje në kategorinë mallra dhe shërbime në shumë prej 15,000.00 €.

Arësytet :

Kërkesa për bartjen e mjetëve në Shëndetësi dhe mirëqenia sociale (730) nën-programi (74050), kodi funksional (0721) shuma prej 15,000.00 € në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime nga mjetët e mbetura në kategorinë ekonomike paga dhe meditje në Shëndetësi dhe mirëqenia sociale (730) nën-programi (74050), kodi funksional (0721), **nuk do të ndikoj në shpenzimet për paga për vitin 2019.**

Kërkesa për bartje në Bujqësi , pylltari dhe zhvillim rural (470) nën-programi (47018), kodi funksional (0421) shuma prej 20,000.00 € në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere nga kategoria shpenzime kapitale, është bërë pasi kemi rekomandim nga auditorët që projektet në bujqësi si : - Serat për bujq,- Furnizim me koshere për bletë ,- Furnizim me centrifuga etj. , duhet të realizohen nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere .

III

Vendimi miratohet me kërkesen e Drejtorisë për Financa , Ekonomi dhe Zhvillim duke u mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi.

IV

Vendimi është i plotfuqishem me miratim në Kuvendin e Komunës dhe hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e Protokollit të Ministries për Vetëqeverisje Lokale si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të komunës , kjo në kuptim të nenit 15 dhe 16 të Rregullorës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/2017 , të dt.23.08.2017 për Proceduren e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës .

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06 - 13267/ 2019
Klinë, më 02-04. 2019

